

# STATUTI

## I SHOQËRISE "2A Construction" shpk

---

Ne Tirane, sot, me daten 01/12/2018, mbeshtetur ne kerkesat e Ligjit nr.9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare me pergjegjesi te kufizuar", redaktohet Statuti, i shoqërise "2A Construction" shpk ,nga ana e ortakut te vetem te shoqërise z.Andi Ulqinaku,lindur ne Tirane ,Shqiperi, me dt. 07.07.1994, shtetas shqiptar, madhor, me pergjegjesi te plote per te vepruar, me vendqendrim te zgjedhur, ne adresen:Rr. " Mustafa Matohiti ",ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit J40707076F, ne cilesine e Perfaqesuesit Ligjor te:- Shoqërise "2A Construction" shpk

### Titulli I

#### Themelimi, emërtimi, objekti, kohëzgjatja, selia

##### **Neni 1: Data e themelimit, emërtimi dhe themeluesit**

(1) Me Akt Themelimi date 01/12/2018 i Shoqërise "2A Construction " shpk ,nga Ortaku i vetem z.Andi Ulqinaku

##### **Neni 2: Objekti**

Shoqëria me pergjegjesi te kufizuar do te zhvilloje veprimtarine me objektin, si vijon:

-Investitor në fushën e ndërtimit.Shoqëria mund te kryeje dhe aktivite te tjera si ndërtime civile , rikonstruksion godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash në mjedise urbane, e tjera ne ndertim si dhe mdermjetesim i cdo lloj kategorie te pasurive te palujshme."

##### **Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërise eshte fiksuar te jete mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit prane Regjistrin Tregetar ne Tirane, por edhe mund te zgjatet ose deklarohet e mbaruar paraprakisht me vendimin e asamblese se ortakeve, ne baze te ligjit dhe ne baze te ketij statuti.

##### **Neni 4: Selia e shoqërise**

Shoqëria ka qendren e saj legale ne Tirane , Rruga "Mustafa Matohiti "Pall. 2/1 ,Ap 12 Tirane .

##### **Neni 5.**

Shoqëria nuk ka pergjegjesi per detyrimet qe nuk kane lidhje me veprimtarine industriale, ekonomike dhe tregtare dhe nuk pergjigjet per veprimtarite e kryera ne menyre autonome dhe private nga ortakut i saj.

Shoqëria pergjigjet ekskluzivisht vetem me sendet e saja.

##### **Neni 6.**

Vendqendrimi i ortakeve, per aq sa u takon marredhenieve te tyre me qendren e shoqërise eshte, per te gjitha efektet e ligjit, ai qe rezulton nga libri i ortakeve.

### Titulli II

#### Kapitali themeltar

## **Neni 7: Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar**

(1) Kapitali themeltar i shoqërise është percaktuar ne leke shqiptare në castin e hartimit të këtij statuti të përditësuar në masën 100.000(Njeqindmije) leke dhe mund te rritet me vendim te asamblese, duke respektuar normat ne fuqi ne kete fushe. Ai eshte i ndare ne kuota, sikunder rezulton nga "libri i ortakeve". Nje kuote me vlere 100.000 (Njeqind mije) leke.

2)Per te realizuar objektivat e shoqerise, palet jane dakord te përdorin kapitalet e tyre respektivisht dhe ne funksion te organizimit dhe zhvillimit te veprimtarise se tyre.

## **Neni 8: Kërkesa për të paguar kuotat e kapitalit themeltar dhe tërheqja e kuotave të papaguara.**

Derdhjet e kuotave perkatese duhen kerkuar nga organi administrativ, ne afatet dhe ne menyrat e kerkuara:

(1) Administratori mund t'i kërkojë ortakut, derdhjen e kontributeve te pa paguara qe kane lidhje me kuotat e nenshkuara prej tij, dhe ortaku, pasi te kete marre njoftimin se paku prej 14 dite te plota, ne te cilin percaktohet afati dhe vendi ku duhet te behet pagesa, i paguan shoqerise shumen e kerkuar per kuotat e veta, sikunder njoftimi parashikon. Thirrja për pagesë mund të parashikojë që pagesa të bëhet me këste. Personi, të cilit i drejtohet thirrja për pagesën e kontributit, përgjigjet për thirrjet që i bëhen pavarësisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së kuotave, me të cilat lidhet thirrja për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një kuote pergjigjen ne menyre solidare për permbushjen e të gjitha kerkesave te pagimit te kontributit, qe kane lidhje me te njejten kuote.

(3) Në rast se nje kerkese per pagese, mbetet e pa paguar deri në mbarimin e të njejtit afat, personi, të cilit i drejtohet thirrja dhe qe është përgjegjës për pagesën, paguan një interes mbi shumën e papaguar, duke filluar nga dita kur mbaron afati, deri në momentin e pagimit, me një normë vjetore interesi prej 4 % (kater perqind).

(4) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, Administratori mund t'i japë një njoftim personit që është përgjegjës për pagesën, nepermjet të cilit i kërkon qe të derdhet shuma e papaguar, së bashku me interesat e maturuara, brenda nje afati prej katërmbëdhjetë ditë. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe në të deklarohet se, nëse pagesa nuk behet, kuotat e pronësisë me të cilat lidhet njoftimi konsiderohen te anuluar.

(5) Në rastin kur, njoftimi nuk zbatohet, kuota per te cilën ben fjale njoftimi, mund të tërhiqet me ven-dim të Administratorit dhe, tërheqja përfshin edhe të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme, qe kane lidhje me kuotat e tërhequra dhe të papaguara, deri në momentin e tërheqjes.

(6) Në varësi të parashikimeve të Ligjit, një kuotë e tërhequr mund të shitet, të rishpërndahet ose të tërhiqet, mbi bazën e kushteve dhe mënyrës që konsiderohen të arsyeshme nga administratori.

(7) Personi, të cilit i perkasin kuotat e terhequra, pushon së qeni ortak në lidhje me kuotat e tërhequra, por vazhdon të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet e papermbushura deri ne ditën e tërheqjes së kuotave dhe, do te pergjigjet duke paguar interesat e maturuara mbi keto kuota, te llogaritura se bashku me koeficientin e aplikueshem per keto kontribute perpara terheqjes.

## **Neni 9: Kuotat, të drejtat dhe kufizimet**

(1) Në varësi të dispozitave të Ligjit dhe pa cenuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tilla, sikunder përcaktohet në vendimin e kualifikuar (me tri të katërtat e votës) të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me Nenin 87.

(2) Ortaket e shoqerise nuk munden, as edhe nepermjet nje personi tjetër, te jene ortake te shoqerive qe ushtrojne veprimtari tregtare konkruuese me shoqerine ose te kene marrredhenie te punesimit ose te bashkepunimit me te. Ortaket jane ne dijeni te ketij fakti, qe nje ndalim i tille shtrihet per periudhen maksimale te kohes te para-shikuar nga ligji, duke filluar nga momenti kur ata humbasin cilesine e ortakut.

## **Neni 10: Certifikatat e kuotave të kapitalit**



Ortakut, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e certifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët, disiplinohet, në bazë të nenit 72 paragrafi (2) të Ligjit n.9901/2008, përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruesve të përbashkët renditen në certifikatën e kuotës.

#### **Neni 11: Kalimi i kuotave me kontratë**

(1) Kontrata e kalimit të kuotave bëhet me shkrim, me akt noterial. Kalimi i kuotës i njoftohet selisë së regjistruar të shoqërisë. Kalimi i kuotes, mund të kundërshtohet nga shoqëria ose nga personat e trete, vetëm pasi t'i jete njoftuar shoqërisë.

(2) Administratori mund të mos pranojë t'a regjistrojë kalimin e kuotës pranë QKR-së, nëse kuota nuk është shlyer tërësisht.

(3) Nëse, Administratori nuk pranon t'a regjistrojë kalimin e kuotës, ai, brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgon marrësit njoftimin për mospranimin.

#### **Neni 12: Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentimit**

(1) Nëse një ortak vdes, trashëgimtarët e tij ligjore janë të vetmit persona, të cilët shoqëria i njeh si titullarë të kuotës të tij; asnjë dispozitë e këtij statuti nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia, në lidhje me kuotën që ai ka pasur në zotërim i ve-tëm ose bashkërisht.

(2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë, si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotërues vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai parashikon kalimin e kuotës, në favor të këtij personi.

(3) Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë, si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, gëzon të drejtat, titullar i të cilave do të kishte qenë si zotërues i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKR-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në asamblenë e shoqërisë.

#### **Neni 13: E drejta e parablerjes**

Ortakeve nëse shoqëria shton numrin e tyre, u rezervohet e drejta e parablerjes në fitimin e kuotave ose pjeses së kuotave eventualisht të ceduara nga ortakët. E drejta e parablerjes duhet ushtruar në afatin e 30 ditëve nga data e komunikimit të parashikimit për kalimin e kuotes së vet ose pjeses së kesaj kuote, e kryer nepermjet letres rekomande drejtuar secilit prej ortakëve dhe vet shoqërisë. Përveç së drejtës së parablerjes, që u rezervohet ortakëve, kuotat e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të trete që nuk bëjnë pjesë në atë shoqëri, me modalitetet e parashikuara nga organi administrativ.

#### **Neni 14: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

(1) Asambleja e Përgjithshme mund ta zmadhojë kapitalin, me vendim të kualifikuar, duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues, me shumën që përcaktohen në vendimin e marrë prej saj. I njëjti vendim i kualifikuar kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

(2) Me anë të një vendimi të kualifikuar, shoqëria mund t'a zvogëlojë kapitalin e vet.

(3) Ortakët, me kërkesën e thjeshtë të organit administrativ të shoqërisë, me kusht që të vendoset me unanimitet dhe në perpjestim me kuotat e poseduara, mund të vënë në dispozicion të shoqërisë fonde të tjera ose mjete financiare për llogari të kapitalit, për të lejuar arritjen e objektivit të shoqërisë. Asambleja mund të vendosë here pas here kushte për shpërblimin e këtyre shumave.



**Neni 15: Blerja e kuotave nga vetë shoqëria**

Shoqëria mund t'i blejë kuotat e veta dhe të bëjë një pagesë në lidhje me blerjen e kuotave të veta, jo nga fitimi për t'u shpërndarë i shoqërisë dhe as nga mjetet monetare të siguruara nga një emetim i ri kuotash, por vetëm nëse shoqëria i plotëson kushtet për shpërndarjen, sikunder parashikohet në nenin 77 të Ligjit dhe, në rast të tillë, Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, të kërkuar nga ky nen. Nëse blerja e kuotave të veta nga shoqëria nuk i përmbush kushtet e nenit 77, mund të ngrihet padi në emër të shoqërisë në përputhje me nenet 78 dhe 79.

**Titulli III  
Asambleja e Përgjithshme**

**Neni 16: Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

(1) Administratori mund të thërrasë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kur t'a mendojë të arsyeshme vetë dhe duhet ta thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme sa herë ta kërkojnë ortakët, në përputhje me Nenin 84 të Ligjit.

Asamblea mund të thirret pranë selisë së saj ose në cdo vend tjetër, në Shqipëri ose edhe jashtë saj.

(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike, që i drejtohet secilit prej ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të për-bashkët. Njoftimi duhet të bëhet të paktën shtatë ditë të plota përpara mbledhjes, por kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtër nëse këtë e aprovojnë shumica e ortakëve që zotërojnë jo më pak se nentëdhjetë përqind të vlerës nominale të kuotave. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe PIN-i për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.

(3) Në rastet kur verifikohen, mungesa e dhënies së njoftimit për thirrjen e mbledhjes ose mosmarrja e njoftimit për mbledhjen, nga personat që kanë të drejtën për ta marrë një njoftim të tillë, konsiderohen shkaqe për të bërë të pavlefshme punimet e mbledhjes, nëse shoqëria nuk provon se personi që nuk e ka marrë njoftimin i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

(4) Asamblea mund të konsiderohet e vlefshme për t'u mbledhur, në kuptim të nenit 83 n.2, edhe në mungesë të formaliteteve të percaktuara në paragrafet e mesiperme, kur i gjithë kapitali themeltar është prezent ose i përfaqësuar dhe kur të gjithë ortakët janë dakord që marrin vendime, pavarësisht nga parregullsia.

(5) Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm, të drejtat dhe detyrimet e asamblese së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm, sipas rregullit të percaktuar në nenin 81, pikë 3, e Ligjit.

**Neni 17: Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

(1) Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të fillojnë, nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në nenin 86 të Ligjit. Ortakët ose zotëruarit e prokurave të votimit mund të jenë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas percaktimit të nenit 88. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë, pasi të paraqesin PIN-in, që u është dhënë, së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Administratori cakton një Kryetar për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur proces verbalin e zhvillimit të mbledhjes.

(3) Nëse Administratori nuk ka dëshirë të jetë Kryetari i mbledhjes ose nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta, duke filluar nga ora e vendosur për të mbajtur mbledhjen, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre për të drejtuar mbledhjen, si Kryesues të saj.

(4) Pavarësisht nëse është ose jo ortak, Administratori ka të drejtën të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

(5) Me pëlqimin e mbledhjes, në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryesuesi mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë; por, në një mbledhje të shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë problem tjetër, me përjashtim të atyre të parashikuara në rendin e ditës. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërmbëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditë të plota, në të cilin përcaktohet



ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e problemeve të parashikuara në rendin e ditës. Përndryshe, asnjë njoftim i tillë nuk do të ishte i vlefshëm.

(6) Vendimet që duhen aprovuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse, përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë:

1. Kryesuesi ose

2. një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se pesë përqind të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.

(7) Nëse deklarata e bere nga kryesuesi nuk është kundërshtuar, kur vendimi është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe është bere regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e asamblese, ky deklarim do të konsiderohet i padiskutu-eshëm, pa pasur nevojë për provën e numrit ose të përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

(8) Nëse deklarata e bere nga kryesuesi kundërshtohet, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të he-dhura pro dhe kundër vendimit.

(9) Vendimet e asamblese duhet të rezultojnë nga një proces – verbal i firmosur nga kryesuesi dhe nga sekretari. Kur organi administrativ e konsideron të pershtatshëm, proces – verbali duhet të redaktohet nga një noter, i cili, në këto rast ben edhe detyren e sekretarit. Proces – verbali duhet të ketë të gjitha kushtet e parashikuara nga neni 90.

(10) Vendimet e asamblese duhet të merren me votim të hapur, ndërsa emerimet e detyrave në shoqëri duhet të merren me votim të hapur ose me votim të fshehtë.

(11) Në rastet e ndryshimeve të statutit, të rritjes ose të zvogelimit të kapitalit themeltar, të shpërndarjes së fitimeve, të riorganizimit dhe të prishjes së shoqërisë, asamblea mund të vendosë në mënyrë të vlefshme, me votën e favoreshme të ortakeve që përfaqësojnë  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakeve pjesëmarrës, sikundër parashikohet nga neni 87 n.1, në kombinim me nenin 86 n.1.

#### **Neni 18:       Votat e ortakëve**

(1) Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, çdo kuotë e ortakut, i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose i përfaqësuar nepermjet një personi të pajisur me prokurë ose (si shoqëri) është i pranishëm nepermjet përfaqësuesit të tij ligjor ose nepermjet një personi të pajisur me prokurë, ka të drejtën e një vote.

(2) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij, në lidhje me kuotën në fjalë.

(3) Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryesuesit. Në rast të kundërt, vendimi i këtij të fundit është i pakundërshtueshëm.

#### **Neni 19:       Votimi me prokurë**

(1) Çdo ortak që ka të drejtën e pjesëmarrjes në asamble, ka mundësinë të përfaqësohet edhe nga një person, që nuk është ortak. Përfaqësimi, që mund të jetë dhënë vetëm për asamble të vecanta, me efekte edhe për asamble të vazhdim të se pares, duhet të leshohen me shkrim dhe dokumentet perkatëse duhet të ruhen në shoqëri.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë me cilesinë e përfaqësuesve të ortakeve në asamble dhe përgjithshme.

(2) Ortaku e lëshon prokurën, sipas formës me të pershtatshme të mund-dur, me kusht që të shprehet qartë vullneti i të përfaqësuarit. Prokura për të marrë pjesë në asamble dhe ortakeve nuk mund të leshohet në të bardhë. Përfaqësuesi mund të zëvendësohet eventualisht vetëm nga personi i treguar shprehimisht dhe paraprakisht në prokurë.

(3) Prokura me shkrim ose një kopje e noterizuar ose e aprovuar nga Administratori mund të depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, sikurse përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 20:       Hetimet e posaçme**

Personat, te cilet plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zë-vendësimin e një auditi të posaçëm, sipas nenit 91 të Ligjit, e bëjnë një kërkesë të tillë, duke depozituar në selinë e shoqërisë një dokument, së bashku me një deklaratë noteriale, e cila vërteton legjitimitimin e këtyre subjekteve për të bërë një kërkesë të tillë.

#### **Titulli IV Administratorët**

##### **Neni 21: Emërimi i administratorëve**

(1) Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator/e të shoqërisë **për 5 ( pesë ) vjet**, sipas nenit 81 n.1, shkronja c) dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet i nënshtrohen individualisht një vendimi të asamblese se zakonshme.

(2) Kufizimet, në lidhje me emërimin e administratorëve, parashikohen në nenin 95, n.2, të Ligjit.

##### **Neni 22: Kompetencat e Administratorëve**

(1) Veprimtaria tregtare e shoqërisë drejtohet nga Administratori, i cili ushtron të gjitha kompetencat e ngarkuara, ne baze të ker-kesave të parashikuara nga nenet 95, 96, 97 e 98, si dhe dispozitave të tjera, të parashikuara nga ky ligj. Administratori është i veshur me pushtetet me të gjera për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, pa pasur ndonjë përjashtim të ndonjë lloji të vecantë dhe ka fakultetin për të permbushur të gjitha veprimet që i konsideron të pershtateshme për zbatimin dhe arritjen e qëllimeve të shoqërisë, përjashtuar ato, që në mënyrë taksative, ligji ia ka rezervuar vetëm asamblese.

Administratori administron veprimet, si vijojnë:

- të blejë, të shesë dhe të shkëmbejë sende të paluajtshme;
- të japë si kontribute sende të paluajtshme, në shoqëri të theme-luara ose që janë duke u themeluar;
- të japë garanci kambiale, nedoresi, garanci e të marrin pjesë dhe në fitime për efektet e arritjes së objektit të shoqërisë;
- të lejojë regjistrime, fshirje dhe shenime hipotekore;
- të heqë dorë prej hipotekave ligjore.

Administratori i zgjedhur ka të drejtën e firmës dhe të përdorimit të vules së shoqërisë dhe përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet, me autoritetet gjyqësore dhe me të gjitha organet e tjera të pushtetit, të administratës publike, me subjektet private, shtetërore dhe publike, edhe pse nuk janë përmendur këtu shprehimisht, sipas normativës së ligjit n.9901/2008,vec e vec dhe/ose bashkërisht dhe sipas këtij Statuti.

Asambleja e përgjithshme dhe/ose Administratorët, që përfaqësojnë së bashku shoqërinë, mund të autorizojnë disa prej tyre të kryejnë disa operacione të posaçme ose të kryejnë disa kategori të vecanta veprimesh. Njoftimet e drejtuara administratorit janë të vlefshme dhe të detyrueshme për shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme emëron administratorin me detyrën e Kryesuesit të mbledhjeve, duke ruajtur të drejtën për ta larguar atë nga kjo detyrë në çdo moment.

Përfaqësimi ligjor i shoqërisë në marrëdhëniet me të tretet dhe në gjykim u takon një ose disa administratorëve, të ngarkuar posaçërisht nga asambleja e përgjithshme, me fakultetin për të emëruar përfaqësues për të trajtuar me ta problemet e shoqërisë, si dhe për ndjekur çështjet në rrugë gjyqësore.

Me vendimin për aprovimin e këtij Statuti, Asambleja e përgjithshme u atribuon zotit Andi Ulqinaku, për gjithë kohëzgjatjen e detyrës së administratorit, përfaqësimin ligjor të shoqërisë në marrëdhëniet me të tretet dhe në gjykim,



me fa-kultetin per te emeruar perfaqesues, per te trajtuar problemet e shoqerise, si dhe per ndjekur ceshtjet ne rruge gjyqesore.

**Neni 23: Shkarkimi nga detyra e administratorit**

(1) Shkarkimi i administratorit mund te ndodhe per shkaqet e meposhtme:

1. Kur shoqeria deklarohet ne likuidim ose ne falimentim;
2. Vuan nga shrregullime mendore ose semundje te tjera qe e bejne te pazote per te ushtruar detyren e administratorit;
3. Jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën shoqërisë; ose
4. Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi, në mbledhjet e shoqërisë, të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, vendos ta liroje nga detyra.
5. Ne te gjitha rastet e tjera, te parashikuara nga ligji.

**Neni 24: Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorëve**

(1) Administratori ka të drejtë të marrë shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme, të ma-rrë në përputhje me nenin 97 të Ligjit.

(2) Asambleja e Përgjithshme mund të japë përfitime, në të holla, pensione, sigurime ose forma të tjera, për ata persona, të cilët kanë punuar më parë për shoqërinë ose për shoqëri të tjera, të cilat janë ose kanë qenë filiale të shoqërisë ose për shoqëri pararendëse të shoqërisë, ose për familjarë të tyre (përfshirë bashkëshortin, bashkëshorten, ish-bashkëshortin ose ish-bashkëshorten) ose për persona të cilët janë në varësi të tyre, dhe mund të japë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla (si përpara, ashtu edhe pasi personi në fjalë pushon së mbajturi vendin ose marrëdhënien e pu-nës).

**Neni 25: Punimet e mbledhjeve të Administratorëve**

(1) Mbledhjet e Administratorëve në rast se shoqëria do të caktojë në të ardhmen me shumë se një të tillë, do mbahen aq herë sa te konsiderohen te nevojeshme.

(2) Mbledhjet e Administratorëve thirren me leter, mesazhe te postes elektronike ose fax, te derguara secilit administrator respektivisht sepaku dhjete dite te plota perpara ose tre dite te plota perpara mbledhjes sebashku me rendin e dites.

Thirrja e mbledhjes iniciohet nga vet Kryesuesi i mbledhjes se administratoreve ose me kerkese se paku te dy administratoreve.

Per vlefshmerine e mbledhjeve te administratoreve eshte e domosdoshme prezenca dhe vota e favo-reshme e dy te tretave te administratoreve ne detyre.

Vendimet duhet te pasqyrohen nga proces – verbalet e nenshkruara nga Kryesuesi dhe Sekretari.

(3) Kuorumi i nevojshëm për të filluar punimet mbledhjet e Administratorëve mund të vendoset prej tyre dhe, nëse nuk vendoset prej tyre, atëherë ky kuorum është dy.

(3) Kryesuesi i mbledhjeve te administratoreve emerohet ne kuptim te nenit 22 te ketij Statuti. Kryesuesi drejton punimet e çdo mbledhjeje të Administratorëve, në të cilat është i pranishëm. Por, nëse Kryesuesi nuk ka dëshirë të drejtojë punimet e mbledhjes ose nëse nuk është i pranishëm për pesë minuta duke filluar nga ora e caktuar për mbledhjen, Administratorët e pranishëm mund të caktojnë njërin prej tyre si Kryesues të mbledhjes.

(4) Vendimet për çështjet që lindin në një mbledhje merren me shumicë votash. Nëse numri i votave është i barabartë, vota e Kryetarit ka perparesi.

**Neni 26: Kufizimet për votimin**

(1) Një Administrator nuk mund te lidhe marrëveshje dhe nuk voton në një mbledhje të Administratorëve për vendime që kane lidhje me një çështje, në të cilën ai ka, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes material ose moral dhe që bie ose mund të bjerë ndesh me interesat e shoqërisë, sipas nenit 13 të Ligjit, nëse të gjithë anëtarët e një mbledhjeje të



Asamblesë së Përgjithshme nuk kanë rënë dakort, për ta autorizuar atë në lidhje me marrëveshjen ose për ta autorizuar atë për të votuar për çështjen në fjalë.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të veçantë. Çdo aprovim i përgjithshëm duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Një Administrator nuk konsiderohet si pjesëtar i kuorumit të pranishëm në një mbledhje në lidhje me një vendim, për të cilin nuk ka të drejtë vote. Për përjashtimin e Administratorit nga marrja e vendimit në një mbledhje të tillë, zbatohet përkatësisht neni 89 i Ligjit.

(3) Nëse në një mbledhje të Administratorëve lind një çështje për sa i takon të drejtës së një Administratori për të votuar, çështja mund t'i kalohet, përpara mbylljes së mbledhjes, Kryetarit të mbledhjes, vendimi i të cilit për të gjithë Administratorët, me përjashtim të ve-tës së tij në rastin kur veri-fikohet një konflikt interesi, konsiderohet i formës së prerë.

#### **Neni 27:       Procesverbalet e mbledhjeve të Administratorëve**

Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen proces-verbalet:

1. E të gjithë takimeve të bëra nga Administratorët, dhe

2. Të të gjitha punimeve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe mbledhjeve të Administratorëve dhe të komiteteve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

### **Titulli V Bilanci dhe fitimet**

#### **Neni 28:**

Vitet ushtrimore mbyllen me 31 Dhjetor të çdo viti.

#### **Neni 29:**

Në fund të çdo viti ushtrimor administratori, brenda gjashtë muajve, mund të procedojë për formimin e bilancit të shoqërisë, të krijuar nga gjendja pasurore, nga llogaritë ekonomike dhe nga inventari.

#### **Neni 30:**

Bilanci i shoqërisë duhet të shoqërohet nga një relacion shpjegues i administratorit, në të cilin evidentohej si ecuria e drejtimit në sektore të ndryshme, në të cilët shoqëria ka vepruar, edhe nepermjet shoqërive të tjera prej saj të kontrolluara, si për investimet, shpenzimet, cmimet, ashtu edhe për faktet e dala në pah pas veri-fikimeve të bëra, pas mbylljes së vitit ushtrimor.

#### **Neni 31:**

Bilanci i shoqërisë dhe relacioni i administratorit duhet të qendrojnë të depozituara pranë qendres së shoqërisë, gjatë pesëmbëdhjetë ditëve përpara asamblese së ortakeve, e thirrur për aprovimin e tyre, gjatë së cilave ortaket mund të njihen me to dhe të kërkojnë kopie me shpenzimet e tyre. Këto dokumente duhet të vihen në dispozicion të eksperteve kontabel të licensuar, sepaku 40 ditë përpara mbledhjes së asamblese, që duhet të bëjë aprovimin e tyre.

#### **Neni 32:**

Secili ortak ka të drejtën për të pasur njoftime nga administrata për zhvillimin e punëve të shoqërisë dhe për të kontrolluar librat e shoqërisë.





## Titulli VI Dividendët dhe kapitalizimi i fitimeve

### Neni 33: Dividendët

- (1) Fitimet neto, pasi të jete hequr nje shume neto jo me pak se 5 perqind per rezerven e domosdoshme, deri ne kufirin e 10 perqind te kapitalit themeltar, duhet t'u shperndahen ortakeve nese do të ketë më shumë se një të tillë, pervec rastit kur asamblea vendos per terheqje qe perdoren per raste te vecanta.
- (2) Pas përmbushjes së kërkesave të nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të shumices se kualifikuar, mund të shpallë divi-dendë në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- (3) Me përjashtim të rasteve, kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u perkasin kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumatat e paguara për kuotat në lidhje, me të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në për-pjesëtim me shumatat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi.
- (4) Dividendet dhe mjetet monetare te pagueshme, në lidhje me një kuotë, nuk mund të fitojnë interesa nga shoqëria, nese një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i perkasin kuotës.
- (5) Pagesa e fitimeve duhet te behet prane qendres se shoqerise, duke filluar nga data e percaktuar nga asamblea e ortakeve, e cila ka vendosur shperndarjen e ketyre fitimeve.
- (6) Ne mungese te caktimit te dates se afatit te pageses te ketyre fitimeve, konsiderohen se jane ne dispozicion te ortakeve prane arkës se qendres se shoqerise, duke filluar nga data e tridhjete vazhduese nga data e shperndarjes se fitimeve ortakeve.
- (7) Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve, nga data kur konsiderohet i kerkueshem, kur Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anu-llohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar t'a paguajë ate. Keto fitime duhen caktuar ne fondin re-zerve te shoqerise.

### Neni 34: Kapitalizimi i fitimeve

Me autoritetin që u jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe duke pasur në konsideratë parimet e vendosura nga neni 14 i Ligjit, Administratori mund të vendosë të kapitalizojë fitimet e pashpërndara të shoqërisë që nuk kërkohen për të paguar dividendë preferencialë.

## Titulli VII Prishja dhe likuidimi

### Neni 35: Prishja e likuidimi

(1) Shoqëria mund te priset me vendim te asamblese se ortakeve, me voten e favoreshme te ortakeve qe perfaqesojne sepaku  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar, sikunder parashikohet nga neni 87, ne kombinacion me nenin 86.

Shkaqe te tjera te prishjes jane:

- Mbarimi i kohezgjatjes;
- Arritja e objektit te shoqerise ose mospermbushja e objektit per shkaqe te pamundesise se paparashikuar;
- Pamundesia e funksionimit ose mosfunksionimi i asamblese;
- Shkaqe te tjera te parashikuara nga neni 99, i ligjit n.9901/2008.

### Neni 36:

Me emerimin e likujdatorit ose te likujdatoreve pushojne funksionet e administratorit.

### Neni 37: Mandati i likujdatoreve

Kohezgjatja e mandatit të likuidatoreve nuk mund të tejkalojë atë të tre vjetëve dhe mund të ripërteritet për arsye të aprovuara bashkërisht nga asambleja e ortakëve me votë të favoreshme të shumicës së kapitalit themeltar.

**Neni 38:**

Likuidatorët përmbushin detyrat e tyre në bazë të nenëve 190-213 të ligjit.

**Neni 39:**

(1) Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me Ligjin, mund t'u shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe, për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

(2) Shpërndarja e aktivitetit të mbetur (pas pagimit të ortakëve të ku-otave të poseduara të kapitalit themeltar), bëhet ndërmjet ortakëve në përputhje me kuotat e poseduara të pjesëmarrjes së tyre në kapitalin themeltar.

Nese aktivitetet që u shpërndahen ortakëve përfaqësohen nga sende të palujtshme ose impiante ose nga të drejta mbi keto të fundit, pro-cedohet me shitjen e tyre me vlerën e tregut dhe të ardhurat do t'u shpërndahen ortakëve në përputhje me kuotat e pjesëmarrjes së tyre në shoqëri.

**Titulli VII  
Situata të tjera**

**Neni 40:**

Të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, zgjidhen nga Ligji n.9901, datë 14.04.2008 "për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 41:**

Përsa nuk është parashikuar në këtë Statut, i duhet bërë referim dis-pozitivave të ligjit në fuqi.

**Neni 42: Njoftimet**

(1) Njoftimet që u jepen personave ose që bëjnë personat, sipas ligjit ose Statutit, duhet të jenë me shkrim.

**Neni 43:**

Ky Statut është përpiluar në pesë ekzemplare origjinale në gjuhën shqipe dhe ka të njëjten vlerë juridike.

Lexuar, aprovuar dhe nënshkruar:

**ORTAKU THEMELUES  
ANDI ULQINAKU**



## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### Shoqeria "AU Construction "sh.p.k.

---

Ne Tirane sot ne date 01/12/2018 une shtetasi Andi Ulqinaku, Atesia ,Petrit ,i datlindjes 07/07/1994,lindur ne Tirane dhe Banues ne Rr.Mustafa Matohiti Tirane , shtetas shqiptar , madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar identifikuar sipas ligjit nepermjet ID **J40707076F**

Me cilesine e **Ortakut themelues** , redaktova aktin e themelimit nepermjet te cilit deklaroj se me vullnet te lire te plote dhe te sinqerte , dhe iniciativen e lire private , mbeshtetur ne Kushtetuten e republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi ne ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite Tregetare" , Ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Tregetare te rregjistrimit " ne ate Doganor , Fiskal e tatimor , krijon shoqerine tregetare

#### **KREU I**

##### **Neni 1**

##### **Emertimi**

Shoqeria do te emerohet "**2A Construction " shpk** dhe eshte shoqeri me pergjegjesi kufizuar .

##### **Neni 2**

##### **Personaliteti juridik**

Shoqeria "**2A Construction " shpk** fiton personalitetin juridik pasi te jete rregjistruar ne QKB ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne ligj

Shoqeria eshte nje shoqeri tregetare e themeluar nga ortakut i vetem i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulon personalisht humbjen e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te pashlyera . Kontributi i ortakut perben kapitalin e rregjistruar te shoqerise.

##### **Neni 3**

##### **Selia**

Shoqeria e ka seline ne rruga "**Mustafa Matohiti**", **Pall.2/1 ,Ap 12 , Tirane.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline , te hape zyra perfaqesie , dege,te krijojte filiale brenda dhe jashte vendit, vetem me *vendim te Ortakut te vetem.*

##### **Neni 4**

##### **Objekti dhe Veprimtaria**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine me objektin, si vijon:

-Investitor në fushën e ndërtimit. Shoqëria mund të kryejë dhe aktivitete të tjera si ndërtime civile, rikonstruksion godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash në mjedise urbane, e tjera në ndërtim, si dhe ndërmjetësim i çdo lloji kategorie të pasurive të palujshme "

---

## **Neni 5**

### **Kohezgjatja**

Shoqëriado të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pakufizuar duke filluar nga data e regjistrimit në QKB

## **KREU II**

## **Neni 6**

### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (Njëqindmijë) leke

Kapitali imesipërm është nënshkruar nga ortakët i vetëm.

Z. Andi Ulqinaku zotëruar i një kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 leke

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme

Kontributi i ortakut mund të jetë me para ose në natyrë (pasuri të lujshme / palujshme apo të drejta)

Ortakët përgjigjet për humbjen e shoqërisë kundrejt të tjerëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë

## **Neni 7**

### **Trasferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit të kapitalit të shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyrë tjetër e parashikuar në ligj

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjet në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga casti i kalimit të kuotave deri në castin e regjistrimit të kalimit të saj në QKB, sipas nenit 43 të ligjit 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Tregëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

## **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

## **Neni 8**

### **Organi Vendimarrës**

Ortakët i Vetëm është Organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë

Ortaku i Vetem eshte organi vendimarrës i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.Cdo ndryshim Statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i Vetem vedos per ceshtje si:

- a)Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b)Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve
- c)Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve she eksperteve kontabel te autorizuar
- c)Percaktimin e shperblimeve
- d)Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret , perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- e)Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te ansamblese

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem rregjistrohen ne nje rregjister te venmdimeve , te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.Duhen rregjistruar ne vecanti , por pa u kufizuar ne to vendimet per:

- a)Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- b)Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
- c)Investime
- d)Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise

#### **Neni 9**

##### **Administrimi**

Administrator i shoqerise eshte **Z.Andi Ulqinaku**, emeruar ne kete detyre per nje **afat 5 (Pese)** vjecar me te drejte perseritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim ortakut te vetem

#### **Neni 10**

##### **Kompetencat**

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a)Kryeje te gjitha veprimet e administratorit te veprimtarise tregetare te shoqerise , duke zbatuar politikat tregetare te vendosura nga ansambleja e [ergjithshme
- b)Perfaqesojë shoqerine ttregetare
- c)Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise
- c)Pergatisi dhe neneshkruaje bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise , dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimit imparaqesin keto dokumenta perpara Ansamblese se Pergjithshme per miratim
- d)Te krijojë nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtje e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- dh)Te kryeje rregjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohen ne ligjin per QKB
- e)Te raportoje para ansamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante , per veprimtarine e shoqerise tregetare

Administratori eshte i detyruar te therrase mbledhjen e ortakut te vetem sdhe ne rastet kur:

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri qe kane vlere me te larte se 5% te aseteteve te shoqerise , qe rezulton na pasqyrat e fundit financiare te certifikuara

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem .Administratori perfaqson shoqerine perpara te gjithe personave fizike e juridike , ;publike dhe/ose private vendas apo te huaj , autoriteteve shteteroreb Shqiptare apo te huaj, perfshi ketun autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve.Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te

shoqerise ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektivat e saj.

Shoqeria nuk merr persiper pasoja ndaj te treteve , kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise , ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena duke pasur parasysh faktin e vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

#### **Neni 11**

##### ***Viti financiar***

Viti financiar i shoqerise fillon ne 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor .Perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet ne 31 dhjetor.

#### **Neni 12**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe;

a)Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne Akt themelimi e saj

b)Me vendim te ortakut te vetem

c)Me hapjen e procedurave te falimentit

c)Nese nuk ka ktyer veprimtari tregetares per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723 dateb 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te rregjistrimit"

d)Me vendim te gjykates

Ne kete rast Ortaku i vetem merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likujdimit te shoqerise duke caktuar 1 ose disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te ncjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe emertesën shkrese "Shoqeri ne likujdim e siper"

#### **Neni 13**

##### ***Baza ligjore***

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Akt Themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi do te zbatohen diapozitat e ligjit "Per tregetares dhe Shoqerite Tregetares ", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter cpecific ne Republiken e Shqiperise.

#### **Neni 14**

##### ***Dispozita perfundimtare***

Ky Akt Themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe , me permbajtje dhe vlera te njejta juridike

Akti i mesiperme pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise Tregetares "2A Construction " neneshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen e tij origjinale

**ORTAKU I VETEM  
ANDI ULQINAKU**

